



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.57/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjorë Lutfie Morina-Ajvazi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Atlant Nila nga Belgjika, ka paraqitur apel kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 20.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli Anr.57/2019, i datës 20.09.2019, e parashtruar nga Atlant Nila, me të cilën kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 20.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Atlant Nila, në të cilën pretendohet se të njëjtit i është refuzuar përfshirja në listën e votuesve jashtë Kosovës për shkak se i njëjti nuk e ka valid dokumentin e indentifikimit- letërnjoftimit me të cilin ka aplikuar.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelimt, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: “*çdo person ka të drejt për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës*”, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: “*votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil*”.

Nga shkresat e lëndës Paneli gjeti se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës i njëjti ka aplikuar me dokument identifikimi- letërnjoftimin e skaduar me dt. 01.05.2019, dhe se me dokumentin e ofruar për regjistrim nuk ka dëshmuar se ka të drejte të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e nenit 5.1 pika a) të LZP-së dhe të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.57/2019 më datën 20.09.2019.

Kryesuesë i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.